

MUHARREM DEZHGIU

IDEJA DHE REALIZIMI I FRONTIT ANTIFASHIST NË SHQIPËRI GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Çështja e krijimit të fronteve antifashiste të luftës në vende të ndryshme, që u angazhuan në Luftën e Dytë Botërore, është një problem historiografik, të cilit i janë kushtuar shumë studime. Si problem historiografik, çështja e krijimit të Frontit Antifashist, lidhet me kushtet e rrethanat historike të çdo vendi, me trashëgiminë politike të mëparshme, por dhe me potencialin intelektual politik të çdo vendi.

Si rregull i përgjithshëm për krijimin e një Fronti Antifashist në vendet evropiane, është shfrytëzuar premisa e ekzistencës së forcave politike të organizuara në çdo vend. Në këtë rast, krijimi i Frontit të përbashkët, kishte një rrethanë lehtësuese, sepse kishte forma organizative të gatshme, për t'u shfrytëzuar në luftën për çlirim kombëtar.

Një problem tjetër që ka lidhje krijimi i Frontit Antifashist në vende të ndryshme, ka të bëjë me rrethanat e pushtimit të huaj, me veçoritë e marrëdhënieve të paraluftës etj. Këto rrethana kanë përcaktuar dhe kohën që bënë të mundur krijimin e Fronteve Antifashiste në vende të ndryshme dhe aderimin e tyre në Frontin Botëror Antifashist.

Mbështetur sa thamë më sipër, edhe për historiografinë shqiptare çështja e krijimit të Frontit Antifashist gjatë Luftës së Dytë Botërore ka qenë objekt i vazhdueshëm debati. Ky debat është fokusuar në rrethanat e brendshme e të jashtme që kanë ndikuar në këtë proces, forcat që bënë pjesë në këtë front, koha dhe rrethanat historike që e bënë të mundur finalizimin e tij. Duhet shtuar këtu se edhe konceptimi i këtij procesi nga historianë të ndryshëm nuk ka qenë i njëjtë.

Me shkrimin që po sjellim do të përpiqemi të japim disa argumente rreth kësaj çështjeje në Shqipëri.

*

* *

Stabiliteti dhe progresi modest i shqiptarëve dhe shtetit të tyre, në vitet 20-30 të shek. XX, pësoi një goditje të madhe me fillimin dhe zhvillimin e Luftës së Dytë Botërore. Diplomacia dhe politika evropiane, përfshirë këtu dhe vendet antifashiste, nuk i vlerësuan arritjet dhe progresin e shtetit shqiptar, si

një argument të mjaftueshëm, për të respektuar me konsekuencë pavarësinë e Shqipërisë. Në të kundërt, Shqipëria u konsiderua si një subjekt mbi të cilin mund të bëheshin ndryshime dhe operacione në favor të interesave të tyre strategjike dhe të lakmive të fqinjëve tanë - grekëve dhe serbëve.

Dallgët e ngritura prej stuhisë së Luftës së Dytë Botërore, në kushtet kur çështja kombëtare shqiptare ishte e pazgjidhur, rrezikonin jo vetëm fundosjen e shtetit shqiptar, por edhe shfarosjen, gjenocidin dhe spastrimin etnik të popullsisë shqiptare, të mbetur jashtë kufijve politik të shtetit shqiptar.

Të vënë përballë këtyre rrethanave të vështira, për shqiptarët shtrohej pyetja: cilat ishin shanset e tyre për të mbijetuar, ata dhe shteti i tyre, i cili ishte arritja më e madhe historike e tyre?

Të gjendur pa aleatë real e të sinqertë, të dobët ushtarakisht, me resurse të kufizuara njerëzore dhe ekonomike, të ekspozuar ndaj goditjeve prej të gjitha anëve, shqiptarëve u mbetej një mundësi e vetme për t'u bërë ballë rreziqeve. E vetmja mundësi, e vetmja armë e rëndësishme që ata mund të shfrytëzonin, për të përballuar rreziqet, ishte bashkimi politik i tyre.

Klasa politike shqiptare, e vjetra dhe e reja, brenda e jashtë Shqipërisë, vihej para detyrës historike, për të bërë sakrificat më sublime, për të shmangur ndasitë dhe çdo lloj konflikti politik; të kapej fort pas legjitimitetit të shtetit shqiptar, i njohur si subjekt ndërkombëtar dhe të bënte të gjitha përpjekjet, për ta fuqizuar këtë aset, në mënyrën më efikase të mundshme.

Ishte kjo premisë historike, e cila duhej të përbënte arsyen logjike më të fuqishme, për formulimin e një qëndrimi të përbashkët të shqiptarëve, në kushtet e pushtimit. Me fjalë të tjera, për përcaktimin e qëllimit strategjik të shqiptarëve gjatë luftës së tyre çlirimtare, që do të çonte në rivendosjen e pavarësisë kombëtare.

Klasa politike shqiptare duke iu referuar përvojës historike, ku ishte shpalosur ndërgjegjja kombëtare për arritjen e bashkimit të shqiptarëve, edhe këtë herë e shfaqti disponimin e saj për bashkim në tre momente historike, gjatë rrjedhës së luftës. Shumica e klasës politike e kishte ndërgjegjen e mjaftueshme për të kuptuar përgjithësisht rreziqet që i kanoseshin vendit.

1. Qëndrimi i mbretit Zog për të mos abdikuar përballë kërcënimeve të pareshtura të Italisë, përbënte një premisë të fuqishme, ku mund të mbështetej klasa politike shqiptare për të organizuar bashkimin e tyre në rezistencën kundër pushtuesit italian. Pozicionimi i qartë antifashist i Zogut në mërgim, dhe përpjekja e tij, relativisht e suksesshme, me emigracionin politik shqiptar në unifikimin e mendimeve për të formuar një front të bashkuar kombëtar, mund të shërbente si një mbështetje e fuqishme, për organizimin e qëndresës antifashiste brenda vendit dhe për koordinimin me të, të përpjekjeve nga jashtë.

Iniciativa politike e Ahmet Zogut në përpjekjet që të bëhej një element bashkimi i shqiptarëve, në luftën kundër pushtuesit, dështoi. Shkak për këtë ishte jo vetëm politika siluruese dhe asfiksuese e qeverisë britanike, në

qëndrimin ndaj Ahmet Zogut, por edhe fakti se, qeveria dhe Zogu mbetën jashtë Shqipërisë, të izoluar nga atdheu dhe nga terreni i luftës. Iniciativës zogiste i mungoi energjia dhe largpamësia për t'u zhvendosur në Shqipëri dhe për t'u kthyer në një faktor të fuqishëm politik, duke vepruar edhe jashtë dëshirës së britanikeve. Atij i duhej të vendoste lidhje me përkrahësit e tij brenda në Shqipëri.

2. Moment i rëndësishëm historik ku u shpалos ndjeshmëria e klasës politike shqiptare në drejtim të përpjekjeve për bashkimin e të gjithë shqiptarëve për luftë, ishte Konferenca e Pezës (16 shtator 1942).

Në këtë konferencë u shtjellua ideja e bashkimit. Kjo çështje u vlerësua me seriozitet, sepse “në kushtet e vendit tonë të varfër, të shtypur dhe pa mjete, [bashkimi] do të ishte arma kundër armikut”.

Konferenca e Pezës u mbledh me iniciativën e komunistëve, por u përkrah nga një grupim nacionalistësh, ku kishte dhe mbështetës të Ahmet Zogut.

Diskutantët iu referuan përvojës historike, ku kishte spikatur nevoja e bashkimit të shqiptarëve, siç ishte Kongresi i Lushnjës. Mbështetur në këtë përvojë nga pjesëmarrësit e Konferencës së Pezës u iniciua propozimi për “krijimin e një organizmi drejtues të bashkimit të shqiptarëve”¹.

Këtë ide të nacionalistëve, e mbështetën dhe diskutantët komunistë. Njëri prej tyre u shpreh se, “ne duhet të shkojmë drejt në luftën kundër armikut të përbashkët pa dallim: jemi shokë lufte”. Por, komunistët e shtynë më tej idenë e bashkimit, duke e motivuar nevojën e arritjes së tij, për zgjidhjen edhe të një detyre tjetër, atë të “vendosjes së një regjimi demokratik”, ku të gjithë të kenë të drejtën të jetojnë të lirë dhe të mendojnë lirisht. Në këtë regjim, thonin ata, i lihet popullit të vendosë mbi fatin e tij”².

Duke shtruar detyrën e vendosjes së një regjimi demokratik lihej në heshtje detyra e rivendosjes së sovranitetit të shtetit shqiptar të paraluftës. Duhet të kujtojmë se mbreti Ahmet Zogu nuk kishte abdikuar dhe as kishte kapitulluar ndaj Italisë, por i kishte shpallur luftë pushtuesit italian. Ai ruante legjitimitetin për vazhdimësinë e shtetit shqiptar të paraluftës.

Ideja e hedhur nga Koço Tashko për vendosjen e “regjimit demokratik” gjeti dhe miratimin e Abaz Kupit. Ky i fundit, edhe pse ishte idhtar i Ahmet Zogut, nuk e shtroi çështjen e bashkimit të shqiptarëve në luftë, duke e lidhur me rivendosjen e regjimit të mëparshëm. Me sa duket, një qëndrim i tillë kishte të bënte me arsye taktike, me qëllimin që të arrihej një bashkim sa më i gjerë i shqiptarëve, përfshirë dhe komunistët, kundërshtarë të deklaruar të mbretërisë

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë / Arkivi i Partisë (më tej: AQSh/AP), Fondi 40, viti 1942, dos.1, fl.2. Procesverbal i Konferencës së Pezës, 17 shtator 1942. Diskutimi i Ramazan Jaranit në Konferencën e Pezës.

² Po aty. Procesverbal i Konferencës së Pezës, 17 shtator 1942. Diskutimi i Koço Tashkos.

shqiptare. Dëshira për të arritur një bashkim sa më të gjerë në luftë, bëri që Kupi të mos e kontestonte kërkesën për “vendosjen e regjimit demokratik” të komunistëve.

Madje, për ta bërë më bindës nevojën e bashkimit sa më të gjerë të shqiptarëve, delegati komunist Ymer Dishnica, u shpreh me sinqeritet se “ishte e panevojshme të bisedohej për të ardhmen, me fjalë të tjera, për regjimin sepse “populli do të vendosë ç’të dojë”³. (Është fjala pas mbarimit të luftës – MD).

Shmangja e vëmendjes së pjesëmarrësve të Konferencës së Pezës nga çështja esenciale që do të realizonte bashkimi i shqiptarëve, për sigurimin e vazhdimësisë së legjitimitetit të shtetit shqiptar të paraluftës, ishte jo vetëm në interes të pushtuesit, por, edhe në favor të atyre forcave, që kërkonin të paraqitnin qëllimin final të luftës, si luftë për zëvendësim pushteti dhe jo si luftë për çlirim kombëtar. Ky qëndrim injorues i tubimit të forcave politike, brenda në Shqipëri, ndaj çështjes së rivendosjes së legjitimitetit të shtetit shqiptar të paraluftës, pati dhe pasoja të tjera që minonin bashkimin. Ky qëndrim i dha një armë veprimi politikës dhe diplomacisë së Fuqive të Mëdha, e veçanërisht e vendeve fqinje për ta vënë në dyshim ekzistencën e shtetit shqiptar, në fund të luftës.

Në Konferencën e Pezës u shtrua detyra për bashkimin e shqiptarëve “pa dallim feje, krahine e bindjeje politike”⁴. Në këtë kuptim, konferenca demonstronte përpjekjen e parë që bënë shqiptarët, për të përcaktuar një formulë politike, e cila do t’i bashkonte ata pa asnjë dallim. Në shtator të vitit 1942, në një konferencë të mbajtur në Pezë – do të vinte në dukje J. Amery – grupet e ndryshme partizane, u bashkuan, për herë të parë, formalisht në një lëvizje që u quajt Lëvizja Nacionalçlirimtare”⁵. Në Pezë “u vunë themelet e Lëvizjes Nacionalçlirimtare, për luftë të paprerë armikut okupator gjer në çlirimin e Shqipërisë”⁶. Nacionalistët, pjesëmarrës në këtë konferencë, i kishin dhënë kësaj lëvizjeje, ngjyrimin e një rezistence nacionale⁷.

PKSH, duke qenë e vetmja forcë e organizuar politike, deri në këtë kohë, orientoi dhe u përpoq ta drejtonte bashkimin e shqiptarëve në kursin e vet, për të propaganduar tek shqiptarët programin e saj politik. Kjo, do të thoshte që këshillat nacionalçlirimtare të konceptuara si organe që do të realizonin bashkimin e shqiptarëve në luftë, do të luanin edhe rolin e organeve të pushtetit të ri që, gjithsesi në thelb, do të ishte komunist.

³ *Po aty*. Diskutimi i Ymer Dishnicës.

⁴ *Po aty*. Rezolucion i Konferencës së Pezës.

⁵ Julian Amery, *Bijtë e Shqipes*, Tiranë: Shtëpia botuese “Lumo Skëndo”, 2002, f. 79.

⁶ Omer Nishani, *Artikuj e ligjërata*, Tiranë: 1945, f.9.

⁷ Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Tiranë: “Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve”, 1993, f. 344.

PKSH, duke shfrytëzuar përparësinë e momentit historik, në atë kohë, si e vetmja forcë politike e organizuar në Shqipëri, arriti të merrte pozita dominuese, jo vetëm në Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (të përkohshëm) që u zgjodh në Pezë, por, dhe në këshillat nacionalçlirimtare, të cilat u krijuan më pas. Në këtë mënyrë, gatishmëria e shqiptarëve, për t'u bashkuar me anë të këshillave nacionalçlirimtare, u shfrytëzua nga PKSH, për të rritur ndikimin e komunistëve, në këto këshilla, me qëllimin e qartë, për ta bërë realitet misionin e tyre, marrjen e pushtetit që gjatë luftës.

PKSH u përpoq ta maskonte synimin e saj, për marrjen e pushtetit që gjatë luftës. Megjithatë, pati mjaft raste, ku këshillat nacionalçlirimtare të cilat duhej të kishin funksione politike, për organizimin e bashkimit të shqiptarëve në luftë, morëntribute të njëanshme, thjeshtë si organe pushteti. Madje, në qarkun e Vlorës, ata u quajtën “sovjete” siç quheshin në Bashkimin Sovjetik. Ndonëse, dukuri të tilla formalisht u kritikuan, në esencë këshillat nacionalçlirimtare ishin në formë e në përmbajtje si organe të pushtetit të ardhshëm komunist. Ato kompromentuan hapur veprimtarinë sektare të PKSH në drejtim të formatimit të një fronti të bashkuar të gjithë shqiptarëve “pa dallim sipas platformës së Pezës”, i cili duhej të realizohej me këshillat nacionalçlirimtare, si organe bashkimi.

Edhe pse u krijua si instrument për organizimin e bashkimit të të gjithë shqiptarëve, Këshilli i Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (i përkohshëm) u mbajt larg këshillave nacionalçlirimtare, duke mos luajtur rolin e tij organizues e drejtues të këshillave nacionalçlirimtare, si organe të bashkimit të shqiptarëve.

Spostimi i rolit të KPNC (të përkohshëm) nga funksioni i organizimit dhe i drejtimit të këshillave nacionalçlirimtare, si organe të bashkimit të shqiptarëve në luftë, zhvlerësoi dhe rolin e nacionalistëve në këtë organizëm të lartë politik të drejtimit të luftës, duke e shndërruar atë, hap pas hapi, vetëm në një maskë të PKSH; në një organizëm të pabesueshëm për shumicën e nacionalistëve. Kjo situatë “i komprometoi “sukseset” e Mbledhjes së Pezës, duke i kthyer në një filluskë sapuni. Shumë nacionalistë u lanë mënjanë”⁸.

Duke vërejtur se si u zbehën idetë e Konferencës së Pezës për bashkimin e shqiptarëve, në forumet e PKSH, u pranua si realitet, se, ajo, “ka pas më tepër vlerë morale”⁹. Si e tillë, Konferenca e Pezës nuk arriti të vendosë themelet e një fronti të bashkuar të shqiptarëve. Mendimet dhe idetë që u parashtruan në Konferencën e Pezës, për arritjen e bashkimit të të gjithë shqiptarëve “pa dallim feje, krahine apo ideje, nuk gjetën zbatim. Realiteti i zhvillimit të ngjarjeve pas saj, nuk i justifikoi shpresat e nacionalistëve që donin të investonin përpjekjet e tyre në interes të një fronti të përbashkët. “Enver Hoxha ishte më shumë i

⁸ *AQSh/AP*, Fondi 14, viti 1943, dos.10, fl.86. Procesverbal i Konferencës I të Vendit të PKSH, mars 1943. Diskutimi i Marshit (Koçi Koxe).

⁹ *Po aty*. Diskutimi i Liri Gegës.

interesuar të siguronte epërsinë e PKSH në rezistencën shqiptare, për të marrë pushtetin, se sa të tërhiqte në luftë një gamë sa më të gjerë të mundshme të fuqive nacionaliste kundër okupatorit”¹⁰.

Propaganda komuniste e reklamoi Konferencën e Pezës si një fitore të saj politike, duke iu referuar faktit se ajo ishte e vetmja forcë politike e organizuar. Madje, theksonte se, në themel të organizimit të saj, ishte programi i partisë. Me këtë propagandë, PKSH synonte ta paraqiste programin e saj si program të frontit të të gjithë shqiptarëve. Në të vërtetë, me këtë që kishte bërë në Pezë ajo kishte arritur të vinte bazat e një lëvizjeje nacionalçlirimtare, të drejtuar nga PKSH. Ajo kishte lënë jashtë saj shumë forca të tjera që nuk e gjenin veten në programin e asaj partie. Në fund të luftës, vetë Enver Hoxha do të pranonte se, “ne vetë nuk e shihnim në dritën e vërtetë Frontin dhe se ç’duhej të përbente e të përmblihte në gjirin e vet ky Front. Përgatitjet dhe punimet tona për këtë konferencë, (Konferenca e Pezës – M.D.) si referatet, mbanin vulën e një pune të improvizuar, të shpejtë dhe me pikëpamje të ngushta”¹¹. Ky pohim na jep edhe një argument, për të vërtetuar se Konferenca e Pezës nuk shënoi krijimin e Frontit Nacionalçlirimtar të trumbetuar me forcë nga propaganda e PKSH, por edhe nga historiografia komuniste apo nga disa autorë, që shkruajnë ende sot për këto probleme historike.

Thirrja e Konferencës së Pezës ishte një përpjekje e ngutshme, për të zbatuar direktivën e Kominternit, të dhënë në gusht 1942. Sipas asaj direktive, thuhej se, “tash për tash Fronti Komunist do të quhet Fronti Nacionalçlirimtar dhe në çdo vend do të krijohen këshillat nacionalçlirimtare”¹². Pra, duket qartë se, emërtimi “Fronti Nacionalçlirimtar do të shërbente si maskë e Frontit Komunist gjatë kohës së luftës, për t’u paraqitur si front i përbashkët i udhëhequr nga një parti e vetme.

Pra, Konferenca e Pezës ishte një përpjekje për bashkim në luftë, konceptuar sipas stilit dhe objektivave komuniste. Ajo e konceptonte Frontin si bashkim politik të shqiptarëve, që do të drejtohej dhe dominohej nga PKSH. Vetë iniciativa e PKSH, për thirrjen e konferencës, synonte të realizonte këto objektiva, sipas porosive të Kominternit.

Koha pas Konferencës, e provoi shumë shpejt këtë synim të PKSH. Ndonëse parulla, për bashkim “pa dallim krahine, feje dhe ideje”, ishte gjithëpërfshirëse, ajo mbeti e tillë vetëm në kuadër të propagandës. Nuk pati shqetësimin e duhur dhe serioz nga ana e iniciatorëve të konferencës, për të

¹⁰ R. Hibbert, *vep. e përm.*, f. 46.

¹¹ *AQSH/AP*, Fondi 14, viti 1944, dos. 2/1, fl. 84. Raport i Enver Hoxhës në Plenumin e II të KQ të PKSH, 23-26 nëntor 1944 në Berat.

¹² *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: *AMPB*) Fondi 148 (Drejtoria e Zbulimit politik), viti 1947, dos. 131-132. Refleksione të Halim Begesë, Reggio Emilia, 16 shtator 1947.

jetësuar atë parullë në realitetin shqiptar të kohës, për bashkimin e gjithë shqiptarëve.

Këmbëngulja e komunistëve në konferencë dhe gjatë luftës për të përdorur simbole dhe emërtime të veçanta, për organizmat e tyre ushtarake (kujtojmë emërtimin çetat partizane dhe jo çetat e lirisë, simbolin e yllit të kuq në vend të shqiponjës në kapelet e partizanëve apo vendosja e komisarëve në çeta, etj.) ngjallën dyshim e mosbesim tek nacionalistët. Simbolet dhe emërtimet e veçanta shprehnin një tendencë të PKSH për individualitet të saj, që nuk konvergonte me idenë e bashkimit të shqiptarëve në një front të vetëm.

Tendenca e komunistëve për t'u dalluar me simbole e forma të veçanta organizimi që nuk mbështeteshin në traditën historike shqiptare për bashkim, nëpërmjet simboleve unike, u pasqyrua dhe në deformimin e rolit të këshillave nacionalçlirimtare. Ato u shndërruan nga organe të bashkimit të të gjithë shqiptarëve në një front të përbashkët lufte, në organe të vëna në shërbim të interesave partiake të PKSH.

Në këto rrethana nacionalistët e gjetën të arsyeshme, të mbanin qëndrimin e tyre. Ata shpалosën programin e tyre, duke krijuar Ballin Kombëtar si organizatë që do të realizonte një program nacionalist. Programi i Ballit Kombëtar ndryshonte në mjaft drejtime nga programi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, të drejtuar nga PKSH, por, në thelb, ai mishëronte platformën e bashkimit për çlirim kombëtar.

Ai shpallte dukshëm synimin për “mobilizimin e të gjitha fuqive të gjalla të kombit shqiptar kundra pushtuesit, për realizimin e idealit të naltë kombëtar”¹³. Koncepti i nacionalistëve mbi organizimin e luftës për “realizimin e idealit të naltë kombëtar”, kishte si qëllim luftën për çlirimin kombëtar të shqiptarëve, pavarësisht se kush ishte pushtuesi i shqiptarëve. Balli Kombëtar e konsideroi një shans historik të shqiptarëve, realitetin e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, ndonëse u bë nga pushtuesi. Prandaj vendosi të përfshinte në programin e vet, vazhdimin e luftës, deri sa “Kosova të jetë pjesë e pandashme e Shqipërisë”¹⁴.

Përpjekja për zgjidhjen e kësaj detyre nuk shtrohej në mënyrë voluntariste e të njëanshme, por brenda kuadrit të marrëveshjes së Aleatëve të Mëdhenj në këtë luftë botërore, e cila kishte vënë në themel të vijës së vet, për zgjidhjen e problemeve mbështetjen në parimin e vetëvendosjes së popujve. Realizimi i këtij parimi në terrenin shqiptar, në fund të fundit, duhej iniciuar e projektuar me përpjekjet e shqiptarëve, me praninë e tyre në këtë proces. Pra, dhe çështja e Kosovës, do të zgjidhej mbështetur në këtë parim, dhe jo të lihej në dëshirën e

¹³ *AQSH/AP*, Fondi 270, viti 1942, dos. 21, fl.1. Dekalogu i organizatës nacionaliste Balli Kombëtar.

¹⁴ *Po aty*, fl. 10. Lufta e çlirimit kombëtar, organ i Ballit Kombëtar, nr. 2, dhjetor 1942.

jugosllavëve, në emër të bashkëpunimit internacionalist, të lëvizjeve nacionalçlirimtare të dy vendeve, të drejtuar nga komunistët, për më tepër, që jugosllavët kishin llogari ndaj shqiptarëve. Arsyetimi i nacionalistëve për këtë qëndrim ishte mjaft i qartë: “Mbretëninat që do të fitojnë luftën, me dashje ose padashje, kur të shohin se si vritemi ne për vendin tonë, kur ta shohin se, ne nuk heqim kurrë dorë prej luftës me na njoft të drejtat tona, do të marrin vesht se ç’ka duam e për ç’ka luftojmë”¹⁵.

Kjo aspiratë e nacionalistëve shqiptarë mbështetej në nenin IV të Kartës së Atlantikut, të 15 gushtit 1941, i cili shpallte se, “asnjë copë tokë s’ka për t’iu lëshuar një shteti tjetër, pa vullnetin e popullsisë së vendit, të shfaqur me plebishit”¹⁶. Mbështetur në këtë parim universal (shprehja e vullnetit me plebishit), Balli Kombëtar shprehej me besim se, “Kosova e Çamëria, toka qind për qind shqiptare, do të jenë në Shqipërinë e rilindur, pjesë të pandashme të shtetit të lirë të pavarur shqiptar”¹⁷. Pra, nacionalistët e konceptonin çlirimin e Kosovës nga zgjedha e huaj, të pashkëputur nga çlirimi i Shqipërisë. Për rrjedhojë, edhe krijimin e Frontit Antifashist, e kërkonin si një Front luftime, që të realizonte bashkimin e të gjithë shqiptarëve, (tashmë të bashkuar dhe administrativisht, sido që në kuadrin e pushtuesit – M.D.) pavarësisht nga krahina ku banonin.

Çlirimi i Kosovës, i cili kërkohet i kushtëzuar nga bashkimi me Shqipërinë, konsiderohet gati si një domosdoshmëri, sepse për nacionalistët “çdo formë çlirimi që të mos jetë i kunorëzuar me bashkimin me mëmëdheun asht, padyshim, një zgjedhë e dytë”.

Lëvizja Nacionalçlirimtare jugosllave, e drejtuar nga PKJ, e cila u bënte thirrje shqiptarëve për bashkim me popujt sllavë, nuk kishte dhënë asnjë garanci ndaj shqiptarëve në Jugosllavi për një qëndrim ndryshe nga regjimi jugosllav i paraluftës. Prandaj, popullsia shqiptare e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare, e shikonte me mosbesim politikën e PKJ. Ajo e konsideronte Lëvizjen Nacionalçlirimtare jugosllave si një vazhduese e politikës së nacionalizmit shoven serb ndaj shqiptarëve, por, me maskë internacionaliste, duke shfrytëzuar rrethanat e luftës botërore kundër fashizmit.

Për shqiptarët e Kosovës ishte më i pranueshëm bashkimi me Shqipërinë, nën suazën e të njëjtit pushtues, se sa të luftonin kundër italianëve, për të ruajtur gjendjen e mëparshme, nën pushtimin serb, egërsinë dhe rrezikshmërinë e të cilit e kishin provuar më parë. Shqiptarët e Kosovës do ta lidhnin fatin e

¹⁵ *Po aty*.

¹⁶ Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria në luftë (1939-1944)*, Tiranë: “Globus R”, 2001, f.181.

¹⁷ *AQSh/AP*, Fondi 270, viti 1942, dos. 69, fl.22. Lufta e çlirimit kombëtar, organ i Ballit Kombëtar, nr. 3, dhjetor 1942.

tyre, në fund të luftës botërore vetëm të kushtëzuar në bashkimin me Shqipërinë dhe jo të mbeteshin përsëri nën pushtimin serb.

Nacionalistët e trajtuan çështjen e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë, si një moment historik që do të realizonte Shqipërinë e vërtetë, në bazë të së drejtës historike. Prandaj, qëndrimi ndaj kësaj çështjeje u konsiderua si gur prove i atdhetarizmit të çdo pjesëmarrësi në luftë.

Dalja e Ballit Kombëtar përbënte një realitet historik që duhej marrë në konsideratë nga Lëvizja Nacionalçlirimtare. Në fillim midis këtyre forcave politike, pati një luftë politike të ndërsjellë, për çështje të caktuara të programit të njëra-tjetrës dhe veprimeve konkrete në terrenin e luftës, që gjithsesi, do të zhvillohej në sensin e përsosjes së bashkëpunimit midis tyre. Lufta politike midis tyre u zhvillua më tepër në nivelet e larta të organizmave të këtyre forcave politike. Kundërshtitë politike nuk gjetën konfrontim në planin konkret, në terrenin e luftës.

Në nivelet e ulëta të organizimit të këtyre forcave, në terrenin lokal e krahinor, gjuha e mirëkuptimit dhe e bashkëpunimit, ishte shumë më evidente dhe më e prekshme. Natyrisht, kjo gjuhë mirëkuptimi, tek anëtarët e thjeshtë të të dyja forcave politike, ngjallte shpresa e optimizëm për arritjen e bashkëpunimit midis tyre, duke iu përgjigjur, në mënyrë adekuate, detyrës së kohës.

Kjo situatë e favorshme disponimi për bashkëpunim, në pranverë të vitit 1943, u konkretizua me disa marrëveshje lokale e krahinore, midis formacioneve e organizmave të dy forcave politike, të formuluarat qartë e me seriozitet. Në këto marrëveshje dallohet qartë “disponimi për një bashkëpunim të sigurtë, për të vazhduar luftën nacionalçlirimtare”¹⁸. Kjo frymë bashkëpunimi u shpreh për shumë aspekte të veprimtarisë së tyre, por spikaste çështja e organizimit të aksioneve të përbashkëta kundër pushtuesit si dhe propagandimi i rezultateve të këtyre aksioneve të përbashkëta. Madje, në ndonjërin nga këto marrëveshje, për të shprehur thelbin e mendimit të përbashkët të komunistëve me ballistët, për krijimin e një Fronti të përbashkët Antifashist, në ndonjë rast, përfaqësuesit komunistë paraqiteshin në bisedime si “nacionalistë të ndershëm”.

Një prezantim i tillë i komunistëve, në bisedimet me nacionalistët, e bënte më joshës dhe më të pranueshëm bashkëpunimin me ta. Më vonë, ndryshoi përmbajtja e emërimit “nacionalistë të ndershëm”. Të tillë u quajtën ata nacionalistë që u bashkuan plotësisht me programin e PKSh dhe iu nënshtruan tutelës së saj.

¹⁸ *Po aty*, Fondi 20, viti 1943, dos.12, fl.2. Raport i Radjunit (Teli Samsuri) dërguar Komitetit Qarkor të PKSh të Korçës mbi bisedimet me nacionalistët, 29 janar 1943.

Fryma dhe mesazhi i marrëveshjeve të arritura në krahina të ndryshme të vendit, krijoi një situatë të favorshme dhe nxitëse që ky bashkëpunim të realizohej edhe nga organizmat drejtuese qendrore të të dyja forcave politike, Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe Ballit Kombëtar. Këtë situatë afrimi dhe bashkëpunimi, midis forcave politike shqiptare, e kishte konstatuar edhe Komanda e Lartë e Trupave Italiane në Shqipëri. Në informacionin e kësaj Komande, duke iu referuar qëndresës shqiptare dhe bashkëpunimit antiitalian të forcave politike, thuhej: “Aktualisht rryma kundër nesh ka marrë formë e fuqi me të vërtetë të shënuar, duke fituar shpirtin e pothuajse të gjithë kombit. Përfundimisht, nuk ekzistojnë tani në Shqipëri korrente (rryma) ose parti politike, por një front i vetëm antiitalian. Jemi përballë një fronti, posaçërisht në qytet, përballë një lëvizjeje nacionaliste komuniste, me synim, që të luftojë bashkimin me Italinë, për të realizuar në formën më të ashpër, programin: Shqipëria e shqiptarëve”¹⁹. Siç duket, ndryshimet midis rrymave politike ose partive politike shqiptare sa i përket qëndrimit kundër pushtuesit, ishin bërë kaq të vogla, saqë, për autoritetet italiane, ishin bërë të padallueshme. Për autoritetet italiane shqiptarët përbënin një “front të vetëm antiitalian”.

Në verë të vitit 1943, krerët e lartë të regjimit të pushtimit italian në Shqipëri, jepnin alarmin se, “ndodhemi në gjendje shumë më kritike nga sa mund të duket. Nuk gjendemi përballë një organizate komuniste terroriste propagandistike, por gjendemi përballë një blloku që formon një front armik, i cili po përgatit me siguri një revolucion shumë të gjerë, mjaft të shpejtë dhe të organizuar mirë...”²⁰. Nuk ishte e rastit dhe pa lidhje që, një javë para këtij alarmi të krerëve të lartë të regjimit, më 20 qershor 1943, Mithat Frashëri, drejtuesi kryesor i Ballit Kombëtar, i kishte argumentuar Abaz Kupit, domosdoshmërinë e një mbledhjeje të përbashkët, për t’iu përgjigjur situatës së krijuar²¹. Kështu nisi procesi i organizimit të një mbledhjeje të nivelit më të lartë të dy forcave politike në Shqipëri e cila do t’i përgjigjej edhe shumë kërkesave të ardhura nga terreni i qëndresës antifashiste për një marrëveshje të tillë, që objektivisht dhe realisht do të shënonte krijimin e një force të bashkuar me emrin Front i vërtetë lufte të shqiptarëve.

Në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (të përkohshëm), të 9 korrikut 1943, u pranua kërkesa, për të krijuar një aleancë

¹⁹ US,MAEI (Arkivi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Italiane). Diario Storico, B.2278, v.1943, fasc.9. Notizie dall’Albania. Al Ministero degli Affari Esteri dal generale Pieche, 12 febbraio 1943.

²⁰ AQSh, Fondi 252, viti 1943, dos.89, fl.5-6. Informacion i ministrit të Punëve të Brendshme për Kryeministrinë dhe Mëkëmbësinë, 27 qershor 1943.

²¹ Uran Butka, *Mukja si shans i bashkimit*, Tiranë: Shtëpia botuese “ASB”, 1998, f.18.

politike e ushtarake bashkëpunimi me Ballin Kombëtar²². Anëtarët e delegacionit të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar që u caktuan në këtë mbledhje, iu përgjigjën Ballit Kombëtar me anë të një mesazhi mjaft konstruktiv. Ky mesazh thirrte i delegacionit të KPNC(P) theksonte se, ai delegacion kishte fuqi të plota për të marrë vendime dhe për të vendosur “mbi të gjitha punët dhe kryesisht mbi bashkimin e forcave të të gjithë kombit në luftë kundër armikut”²³.

Rënia e Musolinit (25 korrik 1943) shënoi fillimin e tatëpjetës së makinës ushtarake të Fuqive të Boshtit, që e tronditi regjimin fashist në Shqipëri. Kjo situatë politike e bënte më të ngutshëm e më të domosdoshëm bashkimin e gjithë shqiptarëve. Duke iu referuar kësaj situatë të përshtatshme për bashkëpunim të forcave politike shqiptare, studiuesit kanë vënë në dukje se, “opinionit publik, presioni dhe përpjekjet e misionit ushtarak britanik si dhe bindja se aleatët do të zbarkonin në Shqipëri nxitën përpjekjet për bashkëpunimin e të dy grupeve”²⁴.

Rrethanat për bashkëpunim ishin kaq të favorshme, sa që të gjitha hallkat e arritjes së marrëveshjes midis nacionalistëve dhe komunistëve ishin në harmoni të natyrshme e në përputhje me interesat kombëtare të shqiptarëve.

Bisedimet paraprahe për arritjen e marrëveshjes, të shumëpritur nga të dy forcat politike, të Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (të përkohshëm) dhe Ballit Kombëtar, u bënë në Tapizë, më 26 korrik 1943. Dy ishin problemet kryesore që u diskutuan në mbledhjen e Tapizës:

1- Organizimi, në një stil të gjerë, i luftës së armatosur kundër okupatorit. Lidhur me këtë çështje, të dyja organizatat pranuan idenë themeltare të formimit të një komiteti të përbashkët me emrin “Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë”.

2 – Problemi tjetër, kishte të bënte me qëndrimin ndaj problemit të Kosovës, si pjesë e çështjes kombëtare shqiptare. Për këtë u arrit në përfundimin që zgjidhja e kësaj çështjeje të kërkohet konform parimit të Kartës së Atlantikut, për vetëvendosjen populje.

Në procesverbalin e bisedimeve u fiksuan përfundimet e kësaj mbledhjeje, të përmbledhura me dy nene: 1) Të formohet një komitet i përbashkët lufte me emrin “Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë”;

2) Në nenin dy, formuloheshin detyrat që do të realizonte programi i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë. Proklamata që iu drejtua popullit shqiptar përcaktonte këtë program pune të Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë:

²² *AQSh/AP*, Fondi 40, viti 1943, dos.3, fl.20-21/1. Procesverbal i mbajtur në mbledhjen e KPNC(P), Labinot, 9 korrik 1943.

²³ *Po aty*, Fondi 40, viti 1943, dos.7.

²⁴ Stavro Skëndi, *Albania*, New York: 1956, f.19.

1. Luftë e përbashkët dhe e menjëhershme, përbri aleatëve të mëdhenj Anglisë, Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Sovjetik, si edhe popujve të shtypun kundër pushtuesit barbar.

2. Luftë për një Shqipni të pavarme, luftë për zbatimin e parimit të njoftuar botërisht e të garantuar nga Karta Atlantike të vetëvendosjes së popujve, për një Shqipni etnike.

3. Luftë për një Shqipni të “lirë, demokratike e popullore. Komiteti për Shpëtimin e Shqipnisë do të vazhdojë luftën tue e udhëhequr popullin shqiptar në rrugën e sakrificës e të nderit, deri në formimin e një qeverie provizore. Forma e regjimit do të caktohet prej vetë popullit me anën e një Asambleje Konstituente, të zgjedhur me sufragh universal direkt”²⁵ (me votim të përgjithshëm të drejtpërdrejtë – M.D.)

Nga detyrat që do të kryente Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, rezulton se, ai nuk kishte asnjë atribut pushteti, por vetëm atributet e një organi politik të përbashkët, për të dyja forcat politike.

KShSh do të luante funksionin e organit më të lartë të Frontit Antifashist të luftës në Shqipëri, duke koordinuar e bashkërenduar veprimtarinë e të dyja forcave politike: të Lëvizjes Nacionalçlirimtare me KPNC(P) në krye dhe të Ballit Kombëtar me në krye Komitetin Qendror të tij.

Vendimi i mbledhjes së 26 korrikut 1943, “për formimin e një komiteti të përbashkët lufte, me emrin Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë” dhe që e konfirmoi Mbledhja e Mukjes ishte një sukses dhe fitore politike për shqiptarët. Për herë të parë, lufta kundër pushtuesit do të drejtohej nga një organ politik i përbashkët. Në kushtet, kur në Shqipëri vepronin dy forca politike të organizuara, Lëvizja nacionalçlirimtare dhe Balli Kombëtar, “Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë” ishte organi më i lartë i bashkimit të shqiptarëve në një Front Antifashist lufte, i cili i përfshinte shqiptarët në luftë, pa dallim bindjeje politike.

Arritja e marrëveshjes për krijimin e “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë”, si organi më i lartë i Frontit të vërtetë të luftës të të gjithë shqiptarëve, ishte në vazhden e traditave më të mira të bashkimit të shqiptarëve. Në ato çaste vendimtare për kombin, klasa politike shqiptare e kohës vuri në plan të parë interesat kombëtare, duke lënë në plan të dytë interesat e pjesshme partiake, ku ndër të tjera, përfshihej dhe interesi për marrjen e pushtetit politik. Por, siç ishte shpallur nga Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë, çështja e pushtetit do të zgjidhej pas përfundimit të Luftës me zgjedhje të përgjithshme dhe të drejtpërdrejta..

Me vendimin për krijimin e “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë”, Mbledhja e Mukjes, zbatoi në shkallën më të lartë dhe më të përsosur

²⁵ AQSh/AP, Fondi 270/1, viti 1943, dos.5. Proklamatë e Komitetit për Shpëtimin e Shqipnisë drejtuar popullit shqiptar, gusht 1943.

politikisht platformën e bashkimit, të shtruar si nevojë e domosdoshme në Konferencën e Pezës, për bashkim politik të të gjithë shqiptarëve në një Front Antifashist unik lufte. Krijimi i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë shënonte finalizimin e një procesi historik, krijimin e Frontit të luftës të të gjithë shqiptarëve, të organizuar në formacione politike të veçanta, me strukturë organizative të tyre, por që në interes të luftës viheshin nën drejtimin e një organizmi të përbashkët, nën drejtimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë. Këto struktura politike, me bëmat dhe veprimet e tyre gjatë procesit të luftës së përbashkët kundër pushtuesit, duke e përdorur këtë kontribut si aset të tyre, do të konkurronin, pas lufte, me zgjedhje të lira, për të gëzuar besimin e mbështetësve për marrjen e pushtetit politik.

Krijimi i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë nuk cenonte strukturat e veçanta organizative të forcave politike. Gjithashtu nuk cenonte as programin e tyre politik, për të ruajtur individualitetin politik të secilës forcë politike. Ky program do t'u lejonte shqiptarëve, pas luftës, për t'u mbështetur në zgjedhjen e një qeverisje, nëpërmjet zgjedhjeve të lira e të përgjithshme, në përputhje me interesat e bindjet e tyre politike.

Ekzistenca dhe roli i forcave politike, me identitetin e tyre organizativ, deri në çlirim, do të shërbente edhe si një rrethanë mjaft e përshtatshme, në mënyrë që Shqipëria e pasluftës, të futej në rrugën e zhvillimit të një demokracie moderne, me një parlament të përbërë nga forca politike me ngjyra dhe bindje të ndryshme.

Krijimi dhe funksionimi i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, si një organ drejtues i Frontit të të gjithë shqiptarëve, do të frenonte tendencat monopolizuese të rezultateve të luftës nga çdo forcë politike e veçantë. Në rolin dhe detyrat e një organi Fronti KSHSH do të frenonte ambiciet e shfrenuara të ndonjë force politike, për marrjen e pushtetit politik para përfundimit të luftës.

Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë nuk kishte funksione pushteti. Si i tillë ai nuk mund të konsiderohej si një organ që ndante pushtetin midis forcave politike. Ai kishte një përfaqësim të barabartë të forcave politike që kishin nënshkruar marrëveshjen, për të ruajtur një ekuilibër politik midis forcave politike në drejtim të luftës.

Pikëpamja e historiografisë komuniste, sipas së cilës, Balli Kombëtar shkoi në Mukje për të ndarë pushtetin me Frontin Nacionalçlirimtar (lexo: me PKSH), nuk ka asnjë bazë historike. Në asnjë nga pikat e marrëveshjes së arritur nuk flitet për një gjë të tillë, sepse, siç e përmendëm në proklamatin e Komitetit, çështja e pushtetit do të zgjidhej me zgjedhje të lira, pas përfundimit të luftës.

Marrëveshja e Mukjes, për krijimin e organit më të lartë politik të Frontit Antifashist të shqiptarëve, në luftën kundër pushtuesit, ishte meritë e gjithë atyre personaliteteve politike që formuluan nyjet më të rëndësishme, që çonin

klasën politike drejt bashkëpunimit, për zgjidhjen e detyrës strategjike të luftës së shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Zbatimi i saj do t'i sillte vendit përfitime të mëdha dhe do ta shtynte përpara procesin historik të bashkimit kombëtar të shqiptarëve. Do të forconte në maksimumin e mundshëm pozitën e kombit shqiptar në Ballkan dhe në Europë. Zbatimi i Marrëveshjes së Mukjes do të ishte triumf i çështjes kombëtare shqiptare, në shkallën më të lartë organizative të saj, në kuptimin më të mirë të mundshëm, në kushtet e luftës botërore. Zbatimi i saj do të shmangte ideologjizimet dhe interesat e ngushta në politikën kombëtare, të cilat ishin vënë re në të kaluarën më të afërt të historisë së shqiptarëve.

Veprimi i parë i Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, në mbledhjen e 3 gushtit 1943, ishte vendimi që “të dy organizatat të urdhërojnë forcat e tyre të armatosura, për të filluar aksione imediate kundër okupatorit, në bashkëpunim me njëra tjetrën, sipas rrethanave”²⁶. Madje, Komiteti hartoi dhe shpalli një proklamantë, drejtuar popullit shqiptar, me vlerë kombëtare, frymëzuese e mobilizuese. “Ardhi koha të çohemi të gjithë, - thuhej në të – të vegjël e të mëdhenj, burra e gra, intelektualë, patriotë, qytetarë, katundarë dhe të rrokni armët për dëbimin sa më të shpejtë të pushtuesit të huaj nga toka e shtrenjtë shqiptare. Ngrihuni të gjithë, pra dhe betohuni rreth Flamurit të Skënderbeut. Bashkohuni rreth “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë” dhe sulmoni në çdo vend e në çdo kënd, me armë e me çdo mjet armikun pushtues”²⁷.

Duke iu referuar situatës në Shqipëri, fill pas Mbledhjes së Mukjes, pushtuesi italian do ta cilësonte atë mbledhje “një bashkim kombëtar që kishte si program përzënien e italianëve nga Shqipëria”²⁸.

Kur pritej që arritja e marrëveshjes të ngjallte gëzim dhe besim dhe të gjente zbatim korrekt në terrenin e luftës, Enver Hoxha, kreu i PKSH, njoftoi, më 8 gusht 1943, të gjitha Komitetet qarkore të PKSH, për të mos e njohur, duke e konsideruar Marrëveshjen e Mukjes në “kundërshtim” me vijën nacionalçlirimtare²⁹. Por, shkaku i vërtetë i prishjes së marrëveshjes nuk ishin kundërshtitë me vijën nacionalçlirimtare, por ajo binte në kundërshtim me interesat e ngushta politike të PKSH, që synonte të merrte pushtetin e vetme. Për udhëheqjen e PKSH ishte e papranueshme ndarja e udhëheqjes dhe e drejtimit të luftës kundër pushtuesit me Ballin Kombëtar. Ymer Dishnicën, kryetarin e delegacionit të Lëvizjes Nacionalçlirimtare do ta trondiste vendimi

²⁶ *Po aty*, Fondi 14, viti 1943, dos.21, fl.10. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit Provizor, 3 gusht 1943.

²⁷ *Po aty*, Fondi 270/1, viti 1943, dos.5. Proklamantë e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, gusht 1943.

²⁸ *Po aty*, Fondi 260, viti 1943, dos.52, fl.25. Kronologjia e ngjarjeve.

²⁹ *Po aty*, Fondi 14, viti 1943, dos.11, fl.13. Qarkore e Komitetit Qendror të PKSH me nënshkrimin “Shpati” (Enver Hoxha), 8 gusht 1943.

për të mos njohur Marrëveshjen e Mukjes. Ai do ta ndjente shumë rëndë goditjen shpirtërore të qarkores të KQ të PKSH për mospranimin e arritjes së kësaj marrëveshjeje, aq sa do ta krahasonte me goditjen e rëndë të një bombe³⁰. Ai i bënte një “apologji” të vërtetë marrëveshjes dhe, veçanërisht, vendimit të saj për krijimin e “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë”. Për këtë, ai sqaronte se ishte “një komitet koordinimi e marrëveshjeje, “pa prekur aspak independencën e organizatave, të shtabeve e të çetave³¹. Që nga 8 gushti, u desh plot një muaj diskutimesh brendapërbrenda Lëvizjes Nacionalçlirimtare, duke gjetur “variantet” e propagandës që do të përdorej për të argumentuar refuzimin e marrëveshjes që ishte arritur në Mukje. Megjithatë, të gjitha versionet që u përmendën, për të mos e pranuar marrëveshjen, ishin krejtësisht të stisura dhe pa asnjë bazë reale. Në thelb, dukej qartë se PKSH kishte si qëllim imediat marrjen e pushtetit, duke e përcaktuar atë si detyrë të radhës së parë, duke mos pranuar për ta ndarë me forca të tjera politike.

Konferenca e Labinotit e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, 4-9 shtator 1943, e dënoi zyrtarisht Marrëveshjen e Mukjes dhe qëndrimin e delegacionit të KPNCÇ e cilësoi si oportunist. Nënshkruesit e marrëveshjes iu nënshtruan një kritike të ashpër në linjën partiake.

Prishja e njëanshme e Marrëveshjes së Mukjes, nga ana e PKSH, me nxitjen e drejtpërdrejtë të emisarëve jugosllavë në Shqipëri, pati pasoja tragjike, jo vetëm për atë kohë lufte, por edhe më vonë. Ndërhyrjet e PKJ në Shqipëri, në verë të vitit 1943, patën pasoja të rënda në jetën politike të Shqipërisë. Dominimi i saj mbi udhëheqjen e PKSH në Shqipëri, do t’i siguronte asaj mjaft përparësi në qëndrimin e mëvonshëm jugosllav ndaj Shqipërisë. Në radhë të parë, çështja e Kosovës dhe e viseve të tjera shqiptare do të zgjidhej siç donte Jugosllavia. Në të gjitha variantet e qëndrimit e PKJ ndaj shqiptarëve, mashtrimi dhe sofizmi ishin evidente³².

Nuk ishte vetëm çështja e Shqipërisë etnike që i shtyu përfaqësuesit jugosllavë në Shqipëri të dilnin kundër Marrëveshjes së Mukjes dhe ta shtynin PKSH ta hidhte poshtë atë.

Marrëveshja e Mukjes, e bazuar në një mirëkuptim të gjerë të forcave politike në Shqipëri, jo vetëm për periudhën e luftës por edhe në etapën pas saj, do të fuqizonte lëvizjen politike kombëtare. Vetëm ajo lëvizje kombëtare mbarëshqiptare do të ishte pengesë për realizimin e synimeve hegjemoniste të Jugosllavisë në Shqipëri e më tej. Duke përdorur akuzat ndaj PKSH për “oportunizëm” apo për “sektarizëm”, sipas interesave të saj, PKJ e mbante

³⁰ *Po aty*, fl.23. Letër e “Shafingas” (Ymer Dishnica) për “Tarasin”, 14 gusht 1943.

³¹ *Po aty*.

³² Fehmi Agani, *Demokracia, Kombi, Vetvendosja*, Pejë: “Dukagjini”, 1994, f. 63.

udhëheqjen e PKSHE të shtrënguar si në një morskë, për t'i imponuar më pas, lëshime të tjera në dëm të çështjes kombëtare shqiptare.

Prishja e njëanshme e Marrëveshjes së Mukjes, me të cilën u institucionalizua Fronti Antifashist në Shqipëri, që do të bashkonte të gjithë shqiptarët pavarësisht nga krahina apo bindja politike në luftën kundër pushtuesit, minoi rëndë çështjen e unitetit kombëtar. Prishja arbitrare e Marrëveshjes së Mukjes pati si rrjedhojë jo vetëm mosjetësimin e Frontit Antifashist që u institucionalizua me krijimin e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë në Mbledhjen e Mukjes, por u goditën parimet themelore të bashkimit të shqiptarëve që u artikulluan në Konferencën e Pezës. Kundërshtarët e Marrëveshjes së Mukjes nuk mund të kishin legjitimitetin të mburreshin as me Konferencën e Pezës, të cilën e monopolizuan, si një aset politik për ta shfrytëzuar në makinën propagandistike mashtruese.

Lëvizja Nacionalçlirimtare, e drejtuar nga PKSHE, nuk mund të përfaqësonte Frontin Antifashist të të gjithë shqiptarëve, siç është thënë nga historiografia komuniste. Emërtimi Fronti Nacionalçlirimtar u shfrytëzua si maskë e programit të PKSHE. Kjo e fundit shpalli në Konferencën e Labinotit, pas dënimit të Mukjes, si detyrë të parë të saj, marrjen e pushtetit nëpërmjet vendosjes dhe shtrirjes së këshillave nacionalçlirimtare, si organe të vetme të pushtetit të saj. Në këtë mënyrë, në kundërshtim me rrjedhën normale të procesit historik të zhvillimit të ngjarjeve politike e ushtarake deri në Mukje, pas saj, vendit iu imponua edhe një luftë tjetër, ajo midis forcave politike shqiptare, pra, një luftë civile. Shtrirja dhe intensiteti i kësaj lufte ndryshonte nga një zonë në tjetrën, në varësi të forcës dhe të ndikimit të njërës apo tjetrës forcë politike.

Kurba e kësaj lufte, që filloi në vjeshtë të vitit 1943, arriti kulmin e saj, në fund të Luftës së Dytë Botërore, duke instaluar me dhunë pushtetin komunist në Shqipëri. Pavarësisht nga roli dhe ndikimi i vendimeve të mbledhjes të Fuqive të Mëdha të Aleancës Antifashiste Botërore me refleks ndaj vendit tonë, fati i Shqipërisë në fund të Luftës, u përcaktua në fund të fundit nga qëndrimi e sjellja politike e tërë klasës politike shqiptare. Unifikimi i qëndrimeve politike të saj brenda e jashtë vendit, do të përcaktonin një rrugë tjetër zhvillimi të Shqipërisë e të shqiptarëve pas Luftës së Dytë Botërore.

Konfrontimi luftarak i shqiptarëve me njëri-tjetrin, për çështjen e pushtetit, ndryshoi dhe strategjinë e rezistencës së shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Fronti Nacionalçlirimtar, i drejtuar nga PKSHE, mbeti një organizëm që nuk mund të përfaqësonte interesat e gjithë shqiptarëve, por vetëm të një grupi politik majtist që gjendej nën influencën e fortë jugosllave.

Njohja e këtij fakti historik, të ekzistencës së luftës civile në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, është e domosdoshme për historianët. Njohja dhe shpjegimi i këtij fakti historik u shërben si çelës historianëve seriozë për

të zbuluar rrënjët e mosmarrëveshjes që, shpesh, i ndan edhe sot më dysh shqiptarët, e që cenon rëndë unitetin kombëtar të tyre.

S u m m a r y

THE IDEA AND THE IMPLEMENTATION OF THE ANTI-FASCIST FRONT IN ALBANIA DURING WORLD WAR II

The process for the creation of the Front in Albania was based on historical circumstances that were created due to the country's occupation, the organization of the inner political forces in Albania and the international circumstances. In this case needs to be considered the attitude of our neighbour countries toward this war and the policy pursued by the Great Powers towards Albania.

The real favourable conditions for the formation of an Anti-Fascist Front of the Albanians in their war against the invaders were created during the summer of 1943. The indications of these favourable conditions were: The political forces that were created in Albania had established an understanding and confidence to reach a joint agreement to unite Albanians "regardless of region, religion and idea".

Based on this approach of these Albanian political forces, the invaders had established the conviction that in Albania was operating a unique anti-Italian front, which was fighting against the union with Italy. The endeavours of the Albanian political exiles lead by Ahmet Zogu had found a common ground with the intention of establishing a government in exile, which would defend the interests of the Albanians.

The creation of the Committee for the Salvation of Albania in Mukja Meeting during August 1943 and the tasks assigned to the Albanian political forces that signed the agreement in order to run the joint war, marked the creation of a true Anti-Fascist Front. The General National-Liberation Council (provisional) that was created in the Conference Peza did not achieve the aim of uniting all Albanians. He remained a guise of the National-Liberation Movement led by KPA and was under its command with the intention to take the power by war.

